

PROGRAMI 2021-2025 QEVERIA RAMA 3



Arsimi, Gruaja dhe
Rinia



Shëndetësia



Ekonomia



Mjedisi dhe Turizmi



Bujqësia



Politika e jashtme



Energjia



Infrastruktura




Fiskale



Politikë



Politika Sociale



Të përgjithshme

100 DITËT E QEVERISË

“RAMA 3”

PËRMBUSHJE DHE

MOSPËRMBUSHJE TË

ZOTIMEVE TË PROGRAMIT

QEVERISËS

ME NE!

100 ditët e qeverisë “RAMA 3”:

Përmbushje dhe mospërmbushje të zotimeve të programit qeverisës

Përgatitja dhe shpërndarja



Ky dokument është përgatitur nga ekspertët e ALTAX nëpërmjet ballafaqimit të zotimeve nga program qeverisës me veprimet dhe mosveprimet e qeverisë në 100 ditët e para të mandatit të saj, 18 Shtator 2021 – 27 Dhjetor 2021

Qendra ALTAX është një nismë studiuësish fiskalistë, juristë dhe ekonomistë shqiptarë me synimin e një qasje të re në ndihmë të politikës shqiptare me qasje drejt politikës fiskale evropiane. Qëllimi kryesor është që të promovojë edukimin me sistemin fiskal dhe përshtatjen e tij sipas ambjentit ekonomik, të ndihmojë tatimpaguesit dhe palët e interesuara (studentët, ekspertët në terren, studiuësit) nëpërmjet ekspertizës të jenë të informuar mbi ambjentin fiskal dhe klimën ekonomike. Nga ana tjetër bashkëpunimi me akademikë dhe ekspertë fiskale ndihmon për të zgjeruar dhe për të krijuar një audiencë të plotë në ndihmë të rritjes së kapaciteteve fiskale në Shqipëri dhe Kosovë.

NE JU JAPIM EKSPERIENCËN, JO VETËM SHËRBIMIN!

www.altax.al
altax@altax.al
www.polifakt.al
info@polifakt.al
Datë 26.12.2021
Tiranë, Shqipëri

PËRMBLEDHJA

Në publikimin mbi analizën e përmbushjes së zotimeve të Programit qeverisës 2021 -2025 në 100 ditët e para të qeverisë është paraqitur gjithë programi me zotimet dhe niveli i përmbushjes së tyre.

Programi qeverisës është i përmbledhur në 78 zotime gjithsej dhe i ndarë në 12 fusha veprimi sektoriale dhe politike.

Nga analiza e bërë në përballjen e zotimeve me realitetin e akteve ligjore të miratuara, me vendimet e Ministrave, me veprimet dhe punën në terren, si dhe nga informacioni dhe analiza e medias shikohet se:

- 40% e zotimeve (31 zotime) nuk rezultojnë të ketë veprime ligjore apo zhvillime të njoftuara nga Ministritë që mbulojnë fushën respektive të veprimit;
- 51% e zotimeve (40 zotime) rezultojnë se janë kryer veprime në terren, apo janë miratuar akte ligjore dhe nënligjore, si dhe njoftime nga media;
- 9% e zotimeve (7 prej tyre) janë përmbushur në 100 ditët e para apo janë miratuar aktet nënligjore përkatëse për tu bërë të zbatueshme.

Në *fushën e arsimit, gruas dhe rinisë* nga 7 zotime të programit rezulton se 4 zotime janë në progres zhvillimi, ndërsa 3 zotime rezultojnë të përmbushura që në 100 ditët e para. Zotimet e realizuara prekin përfshirjen në programe mësimore të gjuhës angleze nga klasa e parë, si dhe klasat sportive. Zotimet që ende njoftohen veprime në progres janë ato që përfshijnë marrëveshjet e firmosura me shtete partnere për ndërveprim të universiteteve shqiptare me to.

Në *fushën e shëndetësisë* nga 9 zotime të programit rezulton se 6 zotime janë ende pa veprime, 2 zotime janë në progres zhvillimi, ndërsa 1 zotim rezulton i përmbushur që në 100 ditët e para. Zotimet që nuk kanë ende veprime të njoftuara/miratuara lidhen me *inovacionin dhe rritjen e përdorimit të teknologjisë së informacionit në shëndetësi, sistem të dhënash që garanton informacion për "shpërndarjen" dhe aksesin në shëndetësi të popullatës, që mundëson një monitorim konstant për adresimin e pabarazive, mospërfundimi i vaksinimit të personave në moshë mbi 60 vjeç dhe ata me sëmundje bashkëshoqëruese shtator 2021 etj. Ndërkohë*

rezulton në progres fillimi i investimeve për spitale rajonale. Një zotim tashmë konsiderohet i përmbushur dhe lidhet me rritjen deri 40% të pagës së mjekëve dhe infermierëve.

Në fushën e ekonomisë nga 7 zotime të programit rezulton se 4 zotime janë ende pa veprime, 3 zotime janë në progres zhvillimi. Zotimet që nuk duket se kanë veprime apo njoftime për zhvillime të reja në 100 ditët e para lidhen me mbështetjen konkrete të sipërmarrjes me fondet e premtuara, me rritjen e të ardhurës së disponueshme në duart e qytetarëve, etj. Ndërkohë, në progres shikohen se janë fond kreditimi prej 10 milionë Euro për manifakturën, ngritja e fashës me disa shkallë më shumë, duke e çuar tatimin 23% mbi pagën 250 mijë lekë/muaj etj.

Në fushën fiskale dhe buxhetore nga 7 zotime të programit rezulton se 3 zotime janë ende pa veprime, 3 zotime janë në progres zhvillimi dhe 1 zotim është i përmbushur. Zotimet pa veprime dhe pa njoftime zhvillimi nga Ministria e Financave dhe AKSHII lidhet me paketën e inovacionit dhe IT. Zotime në progres konsiderohet përjashtimi nga taksat të biznesit të vogël deri në 2029, i cili mbetet të vërtetohet me kalimin e viteve. Zotimi i përmbushur që në 100 ditët e para është përjashtimi nga tatimi mbi pagën aktuale deri në 40 mijë lekë.

Në fushën e mjedisit dhe turizmit nga 5 zotime, rezulton se 2 zotime nuk ka veprime apo njoftime, ndërsa për 3 zotime verifikohet se janë në fazën e progresit të tyre. Në mosveprime të politikave për të mbajtur zotimin për këtë sektor përmendim p.sh. mospatjen e asnjë njoftimi për paketën unike kombëtare për promovimin ndërkombëtar të destinacioneve. Ndër zotimet në progres verifikohen se është zotimi për reduktimin me synim zhdukjen të ambalazhit plastik njëpërdorimësh.

Në fushën e bujqësisë nga 6 zotime, rezulton se 3 zotime nuk ka veprime apo njoftime, për 2 zotime verifikohet se janë në fazën e progresit të tyre dhe 1 zotim verifikohet si i përmbushur. Zotim që ende nuk ka njoftime për zhvillime lidhet me Grantet 5.000 Euro për emigrantët që investojnë në agroturizëm. Në zotimin e përmbushur përfshihet lehtësitë fiskale për sektorin bujqësor.

Në fushën e energjisë nga 5 zotime, shihet se 4 zotime nuk ka veprime apo njoftime, ndërsa për 1 zotim verifikohet se është në fazën e progresit. Zotime pa veprime dhe pa njoftime zhvillimi mund të përmenden Vlora një qendër rajonale për gazin e lëngshëm natyror, nisim punimet për ndërtimin e Parkut Fotovoltaik të Karavastës prej 140 MË. Në zotimin në progres zhvillimi përmenden dy investimet madhore me amerikanët, në Skavicë tjetrin në TEC-in e Vlorës për gazin e lëngshëm.

Në fushën e infrastrukturës nga 8 zotime të programit rezulton se 2 zotime nuk ka njoftime për akte nënligjore apo veprime në terren, për 5 zotime janë në progres zhvillimi, ndërsa

1 zotim rezulton i përmbushur që në 100 ditët e para. Zotimet që nuk ka veprime përfshijnë brenda vitit 2021, përfundimi i Rrugës së Arbrit dhe ndërtimi i rrugës Kardhiq – Delvinë.

Ndër zotimet që janë në progres zhvillimi shihet si premtues *zhvillimi te Porti i Durrësit me investimin prej 2 miliardë Euro dhe fillimi i veprimeve në aeroportin e Vlorës*. Ndërkohë, konsiderohet si zotim i përmbushur që në 100 ditët e para *fillimi i punimeve për hekurudhën Tiranë-Rinas-Durrës*.

Në *fushën e politikës së jashtme dhe politikës sociale* nga 14 zotime gjithsej, 3 i përkasin politikës së jashtme dhe shihet se janë në progres. Ndërsa 11 zotimet e tjera janë për politikën sociale, ku 3 zotime nuk shihet të ketë veprime, ndërsa për 8 zotime duket se janë në progres zhvillimi. Zotimet e politikës së jashtme në progres lidhen *me lobimin për Kosovën, për Ballkanin e Hapur dhe për integrimin europian*. Ndër politikën sociale, rezultojnë pa veprime politika të tilla si: *programi për nënat dhe fëmijët*. Ndërsa konsiderohen në progres gjithë zotimet që lidhen me rindërtimin.

Në *fushën e digjitalizimit, kulturës dhe administrimit publik* nga 10 zotime të programit rezulton se 5 zotime nuk janë ende me veprime të njoftuara, ndërsa 5 zotime janë në progres zhvillimi. Më të detajuara i shikoni në materialin e plotë [“100 ditët e qeverisë “RAMA 3”: Përmbushje dhe mospërmbushje të zotimeve të programit qeverisë”](https://polifakt.al/wp-content/uploads/2021/12/PROGRAMI-QEVERISES-2021-2025-100-DITET-E-PARA.pdf)¹

¹ <https://polifakt.al/wp-content/uploads/2021/12/PROGRAMI-QEVERISES-2021-2025-100-DITET-E-PARA.pdf>

ARSIMI, GRUAJA, RINIA

Në progres 4 Zotime

Të përmbushura 3 Zotime

1. Universitete të spikatura publike të vendeve mike, të jenë integruar në sistemin e arsimit tonë të lartë publik

Statusi:Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 31. Arsimi. Ndërkombëtarizimi i Arsimit të Lartë. Fillojmë punën për hapjen e filialeve të Universiteteve më të mira ndërkombëtare në Shqipëri, si dhe për programe studimi të përbashkëta dhe të dyfishta me to. MASR do të mbështesë hapjen e programeve në gjuhën angleze në të gjitha universitetet shqiptare.

2. Universitetet tona do të njehsohen me universitete publike europiane apo të vendeve të tjera mike

Statusi:Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 31. Arsimi. Ndërkombëtarizimi i Arsimit të Lartë. Fillojmë punën për hapjen e filialeve të Universiteteve më të mira ndërkombëtare në Shqipëri, si dhe për programe studimi të përbashkëta dhe të dyfishta me to. MASR do të mbështesë hapjen e programeve në gjuhën angleze në të gjitha universitetet shqiptare.

3. Do të mbështesim çdo sinergji të plotë mes një universiteti shqiptar dhe një të huaj publik në anglisht

Statusi:Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 31. Arsimi. Ndërkombëtarizimi i Arsimit të Lartë. Fillojmë punën për hapjen e filialeve të Universiteteve më të mira ndërkombëtare në Shqipëri, si dhe për programe studimi të përbashkëta dhe të dyfishta me to. MASR do të mbështesë hapjen e programeve në gjuhën angleze në të gjitha universitetet shqiptare.

4. Libra falas për të gjithë nxënësit e arsimit para-universitar

Statusi:Në progres

Programi Qeverisës 2021 – 2025. Faqe 31. Arsimi. Tekstet shkollore falas për të gjithë nxënësit e arsimit bazë. Për vitin shkollor 2021-2022 janë përfshirë tashmë në skemën për tekstet shkollore në përdorim falas edhe nxënësit e klasës së tetë dhe të nëntë, në total 280 mijë nxënës të arsimit bazë dhe të kategorive të veçanta në arsimin e mesëm të lartë, duke lehtësuar ndjeshëm barrën financiare të familjeve.

5. Gjuha angleze do të nisë të mësohet në të gjithë shkollat e vendit që nga klasa e parë

Statusi:Përbushur

Programi Qeverisës 2021 – 2025. Faqe 31. Arsimi. Të mësuarit e gjuhës angleze që nga klasa e parë e arsimit bazë. Me vitin shkollor 2021-2022 nis mësimi i gjuhës angleze si lëndë e detyruar që nga klasa e parë e arsimit bazë.

6. Edukimi fizik do të zërë një vend më të rëndësishëm në sistemin arsimor, nga klasa e parë deri në universitet

Statusi:Përbushur

Programi Qeverisës 2021 – 2025. Faqe 31. Arsimi. Klasat e profilizuara sportive. Do të rritet numri i klasave të profilizuara sportive në mënyrë progresive në të gjithë vendin, duke filluar që nga viti shkollor 2021-2022 nga 223 në 423, duke shtuar edhe disiplina të reja sportive, si gjimnastikë, atletikë dhe tenis.

7. Pagat e arsimtarëve do të rriten me 40%

Statusi:Përbushur

Programi Qeverisës 2021 – 2025. Faqe 18. Rritja e pagave. Rrisim pagat e mësuesve, mjekëve dhe infermierëve me 40% deri në fund të mandatit tretë

SHËNDETËSIA

Pa veprime 6 Zotime

Në progres 2 Zotime

I përmbushur 1 Zotim

1. Nxsisim inovacionin dhe rritjen e përdorimit të teknologjisë së informacionit në shëndetësi

Statusi: **Pa veprime**

Programi Qeverisës 2021 – 2025 Faqe 14. Një strategji e re për shëndetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm

2. Ndërtojmë një sistem të dhënash që garanton informacion për “shpërndarjen” dhe aksesin në shëndetësi të popullatës, që mundëson një monitorim konstant për adresimin e pabarazive.

Statusi: **Pa veprime**

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 13. Lufta me pandeminë Covid-19

3. Vaksinimi i popullatës kritike, personat në moshë mbi 60 vjeç dhe ata me sëmundje bashkëshoqëruese do të ketë përfunduar brenda shtator 2021.

Statusi: **I përmbushur**

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 13. Lufta me pandeminë Covid-19

4. Rimodelimi i financimit publik për shëndetësinë, modernizimin e sistemit shëndetësor

Statusi: **Pa veprime**

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 34. Shqipëria e shëndetshme. Do të ndërtojmë Programin Kombëtar të mjekësisë së specializuar të lëvizshme me qëllim që qytetarët në zonat më të thella të vendit të kenë akses periodik në shërbimin shëndetësor.

5. Vendosja në punë e 10 qendrave model të mjekësisë familjare

Statusi: Pa veprime

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 34. Shqipëria e shëndetshme. Do të vendosim në funksionim 10 qendra model të mjekësisë familjare, me shërbime të integruara socio – shëndetësore, me fokus problemet e shëndetit mendor, shërbimet për fëmijët dhe të rinjtë dhe kujdesin paliativ brenda 2024

6. I japim përparësi parandalimit të sëmundjeve të transmetueshme dhe jo të transmetueshme

Statusi: Pa veprime

Programi Qeverisës 2021 – 2025 Faqe 14. Një strategji e re për shëndetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm

7. Mjekët do të fillojmë t'i paguajmë jo të gjithë njësoj, por sipas performancës së tyre

Statusi: Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 34. Shqipëria e shëndetshme. Fillojmë pilotimin e modelit të ri të autonomisë spitalore në Spitalin e Ri në Fier brenda vitit 2022 për të vijuar me përshkallëzimin në spitalet e tjera, me qëllim përmirësimin e sistemit të administrimit të spitaleve publike sipas një sistemi që shpërblen mbi bazën e performancës, dhe eliminon çdo abuzim dhe papërgjegjshmëri në kurriz të qytetarëve

8. Katër spitale rajonale të transformuar në qendra reference diagnostikuese

Statusi: Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 34. Shqipëria e shëndetshme. Duke investuar në infrastrukturë e teknologji, brenda vitit 2025 do të kemi katër Pole spitalore që do të bëhen Qendra Reference Diagnostikuese dhe Trajtuese në katër rajonet

9. Pagën për mjekët dhe infermierët do ta rrisim 40% përsëri

Statusi: Përbushur

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 18. Rritja e pagave. Rrisim pagat e mësuesve, mjekëve dhe infermierëve me 40% deri në fund të mandatit tretë.

EKONOMIA

Pa veprime 4 Zotime

Në progres 3 Zotime

1. Rrisim të ardhurat e disponueshme me 20% deri në fund të mandatit

Statusi: I papërbushur (viti 2021)

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 16. Mirëqenie për të gjithë

2. Mbështesim sipërmarrjen në sektorët më produktivë të ekonomisë, për ringritjen edhe më të fortë të tyre pas pandemisë

Statusi: Pa veprime

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 13. Lufta me pandeminë Covid-19.

Mbështesim sipërmarrjen në sektorët më produktivë të ekonomisë, për ringritjen edhe më të fortë të tyre pas pandemisë, duke dedikuar:

- 50 milionë euro për sipërmarrjet në sektorin e turizmit, në formën e instrumentit të garancisë;
- 5 milionë euro për sipërmarrjet në fushën e transportit;
- 50 milionë euro për sipërmarrjet në sektorin e manifakturës, si garanci për kreditim apo zgjatje të afatit të kredive ekzistuese.

3. Nxitje transformimin e proceseve të prodhimit duke mbështetur blerjen e makinerive të industrisë 4.0 nëpërmjet rritjes së indeksit të amortizimit nga 20% deri në 40%

Statusi: Pa veprime

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 19. Biznesi i vogël dhe familja produktive. Do të përdorim instrumentin e amortizimit të përshpejtuar gjatë vitit, për të nxitur investimet me pajisje të prodhuara brenda vendit, me vëmendje në pajisjet që kursejnë energji dhe që janë miqësore ndaj mjedisit, deri në kuotën 40%.

4. Paga mesatare bruto në rang vendi do të shkojë në 85 mijë lekë bruto

Statusi: Pa veprime

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 16. Mirëqenie për të gjithë. Rrisim pagën mesatare mujore bruto me 25% në mënyrë graduale deri në fund të mandatit. Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 18. Rritja e Pagave. Rrisim pagën mesatare në administratë, nga 72 mijë lekë/muaj në 85 mijë lekë/muaj deri në fund të mandatit të tretë

5. Krijohet një fond kreditimi prej 10 milionë Euro për manufakturën

Statusi: Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 19. Biznesi i vogël dhe familja produktive. Viojmë të nxisim sipërmarrjet e të rinjve. Fondi i mbështetjes për sipërmarrjet e reja start-up do të 5-fishohet, duke arritur në 10 milionë euro

6. Ngritje e fashës me disa shkallë më shumë, duke e çuar tatimin 23% mbi pagën 250 mijë lekë/muaj

Statusi: Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 16. Mirëqenie për të gjithë. Tatimi 23% do të fillojë të aplikohet në pagat mbi 200 mijë lekë, dhe më tej, brenda afatit të deklaruar 250 mijë lekë, nga 150 mijë që është sot

7. Rritja ekonomike do të jetë mesatarisht 4.5 % në vit dhe do të mbështesë një rritje edhe më të madhe të pagave në nivel vendi

Statusi: Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 16. Mirëqenie për të gjithë

FISKALE DHE BUXHETORE

Pa veprime 3 Zotime

Në progress 3 Zotime

I përbushur 1 Zotim

1. Paketa e inovacionit dhe IT. Kostot do të rimbursohen 50% direkt dhe 50% si dyfish i tatimit të zbritshëm

Statusi: Pa veprime

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 19. Biznesi i manifakturës, teknologjisë së informacionit dhe shërbimeve.

Do të krijojmë programet “Inovacion dhe ekselencë në manifakturë” dhe “Inovacion dhe ekselencë në IT” për trajnime në inovacion, dizajn, marketing, kërkim dhe zhvillim nëpërmjet mbulimit të kostove të trajnimit 100%.

Kostot do të rimbursohen 50% direkt dhe 50% si dyfish i tatimit të zbritshëm ndaj shoqërive ku është i punësuar përfituesi.

Faqe 23. Biznesi i manifakturës, teknologjisë së informacionit dhe shërbimeve. Krijojmë instrumentin e garancisë për kreditim në IT prej 50 milionë euro.

2. Biznesi i vogël nuk do ketë më inspektor te dera, nuk do ketë më kontrolle fare sepse gjithçka do jetë dixhitale

Statusi: Pa veprime

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 18. Mirëqenie për të gjithë

3. Prej 1 janari 2023, rimbursimi i TVSH-së do të jetë automatik

Statusi: Pa veprime

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 18. Mirëqenie për të gjithë. Nga 1 janari 2023, rimbursimi i TVSH-së për bizneset do të jetë automatik

4. Politika e bonusit të pensioneve të fundvitit do të kthehet në një politike permanente të rritjes së pensioneve, përtej indeksimit, pa rrezikuar skemën dhe reformën e arritur. Kjo politike do të garantojë një rritje të vazhdueshme vjetore prej mbi 5% për çdo pensionist

Statusi: Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 33. Kujdesi për të moshuarit dhe qytetarët në nevojë.

5. Do të rriten me 30% pagat e administratës publike

Statusi: Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 16. Mirëqenie për të gjithë. Risim pagat e administratës publike

Faqe 18. Rritja e pagave. Risim pagat e punonjësve të administratës publike me 30% deri në fund të mandatit të tretë

6. Biznesi i vogël do t'i ketë taksat dhe TVSH-në zero deri në vitin 2029

Statusi: Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 19. Biznesi i vogël dhe familja produktive. Biznesi i vogël me zero taksë

7. Do të hiqet taksë mbi pagën aktuale deri në 40 mijë lekë

Statusi: Përbushur

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 17. Mirëqenie për të gjithë. Risim dyshemenë për pagat e pa-tatueshme nga 30 mijë në 40 mijë lekë në muaj. Me këtë masë, 435 mijë të punësuar, ose 63.8% e totalit të punësuarve, paguajnë zero taksë

MJEDISI DHE TURIZMI

Pa veprime 2 Zotime

Në progress 3 Zotime

1. Agroturizmi do të mbështetet jo vetëm financiarisht, por edhe me harta, rrugë, infrastrukturë lokale, promovim unik

Statusi: **Pa veprime**

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 20. Zhvillimi i bujqësisë dhe fshatit.
– Mekanizmave mbështetës për rritjen e numrit të bizneseve agroturistike dhe bujtinave.
– Politika nxitëse dedikuar emigrantëve, të rinjve dhe rritjes së përfshirjes së grave në sektor

2. Paketë unike kombëtare për promovimin ndërkombëtar të destinacioneve, paketë në të cilën shteti shqiptar do të investojë 10 milionë Euro çdo vit

Statusi: **Pa veprime**

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 25. Turizmi dhe mjedisi.
– Inkurajimi i brandeve të mirënjohura ndërkombëtare për të investuar apo operuar në Shqipëri.
– Përfundimi i procesit të lëvizjes së mjeteve lundruese përmes platformës online të hyrje-daljeve.
– Promovimi i Flamurit Shqiptar në tregun ndërkombëtar, si destinacion tax-free.
– Riorganizim i Agjencisë Kombëtare të Turizmit në përgjigje të flukseve të pritshme turistike dhe të kërkesave në rritje të operatorëve turistikë

3. Reduktim me synim zhdukjen të ambalazhit plastik njëpërdorimësh

Statusi: **Në progres**

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 25. Turizmi dhe mjedisi

4. Menaxhim i integruar i mbetjeve në tërësinë e territorit sipas Masterplanit

Statusi: Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 25. Turizmi dhe mjedisi.

5. Riorganizim i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, me ligj të ri të dedikuar Menaxhimin e Integruar të Bregdetit, si dhe forcimi i bashkëpunimit ndërinstytucional me Bashkitë bregdetare

Statusi: Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 25. Turizmi dhe mjedisi

BUJQËSIA

Pa veprime 3 Zotime

Në progress 2 Zotime

Të përmbushura 1 Zotime

1. Eksportet bujqësore i kemi rritur në 400 milionë US. D, ishin rreth 100 milionë US.D. Do t'i çojmë mbi 1 miliardë US.D

Statusi: Pa veprime

Programi Qeverisës 2021 – 2025. Faqe 21. Zhvillimi i bujqësisë dhe fshatit.
– Rritja e aksesit në tregje të reja ndërkombëtare nëpërmjet informimit dhe lehtësimit të marrëveshjeve tregtare.

– Orientimi i investimeve në shtimin e zinxhirit të vlerës në agro-përpunim.
– Lehtësirave në blerjen e makinerive dhe pajisjeve të agro-përpunimit duke i ofruar sipërmarrjeve ekzistuese të përdorin një amortizim të përshpejtuar me dy herë.

2. Gjashtëmbëdhjetë milionë US.D në vitin 2025 për të mbështetur më shumë kultura të mbjelljes

Statusi: Pa veprime

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 21. Zhvillimi i bujqësisë dhe fshatit.

3. Grant 5.000 Euro për emigrantët që investojnë në agroturizëm

Statusi: Pa veprime

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 19. Biznesi i vogël dhe familja produktive. Do të mbështesim emigrantët që të transferojnë në Shqipëri njohuritë e aftësitë e marra, përmes mbështetjes në formë granti në vlerën 5 mijë euro, për çdo biznes të nisur nga një emigrant i kthyer

4. Do të garantojmë aksesin në programin IPARD III me fond financimi 166 milionë Euro

Statusi:Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 21. Zhvillimi i bujqësisë dhe fshatit. 146 milionë euro mbështetje nëpërmjet programit IPARD III.

5. Shtatëdhjetë milionë euro mbështetje të drejtpërdrejtë për fermerët nëpërmjet naftës pa akcizë dhe skemave kombëtare të mbështetjes

Statusi:Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 21. Zhvillimi i bujqësisë dhe fshatit

6. Lehtësi fiskale për sektorin bujqësor

Statusi:Përbushur

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 21. Zhvillimi i bujqësisë dhe fshatit. TVSH zero për:

- makinat bujqësore si në import ashtu dhe brenda vendit;
 - 27 zëra doganorë të peshkimit;
 - rrjetat, anijet, pajisjet elektronike, frigoriferët, motorët e anijeve etj. në bordin e anijeve të peshkimit, të trajtuara si furnizime bordi;
- Tarifa zero për regjistrimin dhe vaksinimin e detyruar të blegtorisë;*
Blerja e gazoilnit nga anijet e peshkimit me 0 akcizë, 0 taksë karburant dhe 0 taksë karboni;
Tatim fitimi 5% për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor.
Tatim fitimi 5% për sipërmarrjet IT

ENERGJIA

Pa veprime 4 Zotime

Në progres 1 Zotim

1. Bursa Shqiptare e Energjisë do të bëhet krejtësisht operacionale në Shkurt të vitit 2022

Statusi: **Pa veprime**

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 24. Energjia

2. Shqipëria kthehet në eksportues neto të energjisë

Statusi: **Pa veprime**

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 8. Energjia. Mirëqenie për të gjithë

3. Vlora një qendër rajonale për gazin e lëngshëm natyror

Statusi: **Pa veprime**

Programi Qeverisës 2021 – 2025. Faqe 24. Energjia. Brenda qershorit 2022 nënshkruajmë kontratën për fillimin e punimeve për TEC Vlorë, projekt i cili përfshin konvertimin e TEC Vlorë me LNG (gaz të lëngshëm natyror), tek ndërtimi i një terminali rigazifikimi, e deri tek shpërndarja në shkallë të vogël e LNG, duke shndërruar Vlorën në një HUB rajonal

4. Nisim punimet për ndërtimin e Parkut Fotovoltaik të Karavastasë prej 140 MW, më i madhi në Ballkan, në pranverën e vitit të ardhshëm (Mars 22)

Statusi: **Pa veprime**

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 24. Energjia

5. Dy investime madhore me amerikanët, në Skavicë tjetrin në TEC-in e Vlorës për gazin e lëngshëm

Statusi:Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 24. Energjia. Brenda marsit të vitit 2022 nënshkruajmë kontratën për projektimin dhe ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës, HEC-i më i madh në vend

INFRASTRUKTURA

Pa veprime 2 Zotime

Në progres 5 Zotime

I përmbushur 1 Zotime

1. Brenda vitit 2021, përfundimi i Rrugës së Arbrit

Statusi: I papërmbushur

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 23. Transporti ajror, rrugor, hekurudhor dhe detar. Përfundojmë brenda vitit 2021 punimet për ndërtimin e Rrugës së Abrit

2. Ndërtimi i rrugës “Kardhiq-Delvinë”

Statusi: I papërmbushur

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 23. Transporti ajror, rrugor, hekurudhor dhe detar. Aksi Kardhiq-Delvinë do të përfundojë tërësisht në pranverën e vitit të ardhshëm (Maj 2022)

3. Tridhjetë miliardë e 700 milionë Lekë ku pjesa kryesore do të jetë për grante rikonstruksioni e rindërtimi dhe për banesat

Statusi: Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 12. Rindërtimi. 4.500 banesa të reja individuale do të përfundojnë, duke strehuar të gjithë banorët që humbën shtëpitë e tyre

4. Njëzetë e tetë kantiere të reja të infrastrukturës publike do të kenë përfunduar deri në pranverën e vitit 2022

Statusi: Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 12. Rindërtimi

5. Porti i Durrësit me investimin prej 2 miliardë Euro

Statusi:Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 23. Transporti ajror, rrugor, hekurudhor dhe detar. Nisim në Janar 2022 punën për transformimin e Portit aktual të Durrësit në një hapësirë moderne të kompletuar me një marinë jahtesh, infrastrukturë turistike dhe komplekse rezidenciale që do pozicionojë Shqipërinë në hartën e turizmit elitare mesdhetar

6. Ndërtimi i aeroportit të ri në Sarandë

Statusi:Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 23. Transporti ajror, rrugor, hekurudhor dhe detar. Brenda vitit 2021 nënshkruajmë kontratën për ndërtimin e SIA (Saranda International Airport)

7. Ndërtimi i aeroportit në Vlorë

Statusi:Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 23. Transporti ajror, rrugor, hekurudhor dhe detar. Nisim punimet për VIA (Vlora International Airport) brenda vitit 2021 që ky aeroport të jetë operacional më 2024

8. Nisim brenda vitit 2021 punimet për Hekurudhën Tiranë-Rinas-Durrës

Statusi:Përbushur

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 23. Transporti ajror, rrugor, hekurudhor dhe detar

POLITIKA SOCIALE

Pa veprime 3 Zotime

Në progres 8 Zotime

1. Programi për nënat dhe fëmijët

Statusi: Pa veprime

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 30. Fëmijët.

- Me fokus kujdesin për nënat e reja dhe të porsalindurit, vijojmë investimet në rrjetin e materniteteve dhe brenda vitit 2022, dy spitalet universitare të obstetrisë-gjinekologjisë do të kenë shërbime të reja diagnostikuese dhe trajtuese me infrastrukturë moderne.
- Financojmë paketën e fertilitetit falas duke filluar nga viti 2022.
- Krijojmë dy programe të dedikuara falas për kujdesin e syve dhe atë oral, për të gjithë fëmijët e moshës 6-15 vjeç.
- Fillojmë punën për ndërtimin e Qendrës Kombëtare për Fëmijë brenda qershorit 2022. Kjo qendër me sipërfaqe rreth 4500 m², pranë liqenit artificial të Tiranës, do të jetë një pol kulturor multifunksional, dedikuar fëmijëve si pjesë e Tirana Park Extension

2. Familjeve të reja do t'u ofrojmë 1 milion lekë mbështetje për pagesën fillestare dhe zbutjen e interesit për blerjen e shtëpisë

Statusi: Pa veprime

Programi qeverisës 2021 -2025. Faqe 29. Familja

3. Subvencionimin me pagesë me çerdhet dhe kopshtet private, për subvencionimin e pagesës

Statusi: Pa veprime

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 30. Fëmijët. Ofrojmë 10 mijë lekë /muaj për shpenzimet e çerdhes/ kopshtit për familjet me të ardhura deri në 100 mijë lekë/muaj

4. Brenda vitit 2022, përfundon ndërtimi i rreth 12 mijë apartamenteve në lagjet e reja dhe rehabilitimi i 160 shkollave, 13 mijë familjet që po trajtohen aktualisht me bonus qiraje do të vijojnë të marrin bonusin dhe përfitimet e tjera deri në ditën që do t'u dorëzohen çelësat e shtëpisë së re në dorë

Statusi: Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 12. Rindërtimi

5. Adresojmë pabarazinë mes kategorive të ndryshme sociale të shkaktuar nga Pandemia – ndjekim politika të dedikuara për shtresat më të prekura të popullsisë dhe mundësojmë rritjen e aksesit të tyre në kujdes shëndetësor e social

Statusi: Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 14. Një strategji e re për shëndetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

6. Nëpërmjet Fondit Social, do të zgjerohet rrjeti i qendrave dhe shërbimeve të reja në territor për fëmijët, gratë dhe të moshuarit në nevojë në të gjitha bashkitë e vendit si dhe do të mbështetet krijimi i 11 ndërmarrjeve sociale me qëllim mbështetjen e grave dhe vajzave

Statusi: Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 33. Kujdesi për të moshuarit dhe qytetarët në nevojë.

7. Rrisim me 10% përfshirjen e grave kryefamiljare në skemën e ndihmës ekonomike

Statusi: Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 33. Kujdesi për të moshuarit dhe qytetarët në nevojë.

8. Zgjerojmë mbulimin e familjeve të varfra me skemën e ndihmës ekonomike, me përparësi familjet e komunitetit rom dhe atij egjiptian, me 10% në vit

Statusi:Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 33.Kujdesi për të moshuarit dhe qytetarët në nevojë.

9. Zgjerojmë skemën e mbulimit të familjeve dhe individëve në nevojë si dhe risim aksesin ndaj punësimit duke përmirësuar lidhjen me skemat e punësimit, me shërbime të integruara për të arritur riintegrimin social të tyre në jetën shoqërore

Statusi:Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 33.Kujdesi për të moshuarit dhe qytetarët në nevojë.

10. Rrisim numrin e grave kryefamiljare, personave me aftësi të kufizuara, jetimëve dhe komunitetit rom e egjiptian si përfitues prioritarë të programit social për strehimin

Statusi:Në progres

Programi qeverisës 2021 -2025. Faqe 29. Familja

11. Programi i banesave sociale në bashkitë e mëdha me prurje të lartë demografike, do të ndërtohen rreth 2000 mijë banesa në vit për familjet të cilat nuk përfitojnë nga paketa e familjeve të reja, përmes një instrumenti të posaçëm të garancisë sovrane nga qeveria. Programi nis brenda vitit 2022 me një fond 100 milionë euro të Bankës Europiane të Investimeve

Statusi:Në progres

Programi qeverisës 2021 -2025. Faqe 29. Familja

1. Integrimi Evropian

Statusi: Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 39-40. Integrimi Evropian.

- Mbajtja e Konferencës së parë Ndërqeveritare për integrimin në BE dhe ndjekje e rekomandimeve për çdo etapë.
- Çojmë përpara nismën Ballkani i Hapur – vijojmë punën për të ndjekur zbatimin e 3 marrëveshjeve të lidhura në takimin e datës 29 korrik 2021 midis Kryeministrit Rama, Kryeministrit Zaev dhe Presidentit Vuçiç, por edhe për të eksploruar mundësi të reja bashkëpunimi mes 3 vendeve pjesëmarrëse.
- Llojmë më fuqimisht për njohjen e shpejtë të Kosovës nga të gjithë vendet e botës dhe për pranimin e saj si një vend me të drejta të plota në OKB.
- Takimi i përvitshëm i qeverive Shqipëri-Kosovë zgjerohet për të përfshirë në tryezë edhe pakicat shqiptare në të gjithë rajonin

2. Mbrojmë interesat e gjithë shqiptarëve

Statusi: Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 39. Mbrojmë interesat e gjithë shqiptarëve.

- Angazhohemi në përforcimin e bashkëpunimit rajonal përmes Open Ballkan dhe paketës së ndërlidhjes dhe investimeve të Procesit të Berlinit.
- Llojmë më fuqimisht për njohjen e shpejtë të Kosovës nga të gjithë vendet e botës dhe për pranimin e saj si një vend me të drejta të plota në OKB.
- Takimi i përvitshëm i qeverive Shqipëri-Kosovë zgjerohet për të përfshirë në tryezë edhe pakicat shqiptare në të gjithë rajonin

3. E çojmë Shqipërinë në një nivel tjetër që të jetë në një pozicion që nuk mund të kthehet më pas

Statusi:Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 38.Konsolidojmë imazhin dhe Rolin e Shqipërisë.

– Forcimi i perceptimit pozitiv, i parashikueshmërisë dhe i besueshmërisë së politikës së jashtme të Shqipërisë.

– Forcimi dhe intensifikimi i marrëdhënieve me vende dhe organizata partnere, nëpërmjet punës së përbashkët dhe të bashkërenduar për tema të posaçme.

– Vendosja e kontakteve me vende dhe organizata që nuk kanë qenë në vëmendjen e politikës sonë të jashtme, shfrytëzimi më tej i këtyre kontakteve në shërbim të arritjes së objektivave afatgjata të politikës së jashtme të vendit tonë.

– Forcimi dhe faktorizimi sa më shumë të jetë e mundur i pozicionit të Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare

POLITIKË, ADMINISTRIM, KULTURË

Pa veprime 5 Zotime

Në progres 5 Zotime

1. Reforma në drejtësi

Statusi: Pa veprime

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 36. Shqipëria e së drejtës. Risim numrin e magjistratëve në Shkollën e Magjistraturës. Risim aksesin e qytetarëve nëpërmjet digjitalizimit të sistemit të drejtësisë përmes krijimit dhe vendosjes në operim të Platformës "Drejtësia Ime". Hartojmë dhe miratojmë ligjin e Arbitrazhit tregtar dhe mekanizmave të tjerë të drejtësisë alternativave.

Hartojmë Kodin e ri Penal për të ashpërsuar goditjen ndaj kriminalitetit dhe pandëshkueshmërisë.

Zgjerojmë dhe fuqizojmë rrjetin e koordinatorëve kundër korrupsionit.

2. Do të mbyllim përfundimisht pronën si çështje, qoftë në qytet, qoftë në fshat

Statusi: Pa veprime

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 37. Siguria e pronës. I japim fund procesit 30-vjeçar të ndërtimeve pa leje brenda vitit 2022, ku asnjë banesë shqiptare që mund të legalizohet, nuk do të ketë mbetur pa u legalizuar

3. Përfundojmë projektin e Rijetëzimit të Amfiteatrit Durrës

Statusi: Pa veprime

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 26. Kultura

4. Marrja e përgjigjes online me nënshkrim, vulë elektronike për të gjitha shërbimet në e-albania që janë aplikime

Statusi: Pa veprime

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 27. Shoqëria digjitale. Sigurojmë marrjen e përgjigjes online me nënshkrim ose vulë elektronike për të gjitha shërbimet në e-Albania, si dhe digjitalizojmë arkivat fizike për të rritur numrin e shërbimeve që merren në kohe reale me vulë elektronike

5. Shqipëria e sigurtë

Statusi:Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 41. Shqipëria e sigurtë.

- Sigurojmë kontrollin e plotë të territorit, veçanërisht ndaj ndërtimeve pa leje nëpërmjet përdorimit të teknologjisë dhe investimeve të konsiderueshme në sistemet inteligjente bashkëkohore për monitorimin e veprimtarive të kundër-ligjshme e për sinjalizimin e rrezikut.
- Hartojmë ligjin që siguron dhe zgjeron aksesin e Policisë së Shtetit në regjistrat e llogarive bankare, në regjistrin e pronarëve përfitues, të pasurive të paluajtshme, noterëve, transaksioneve të dyshimta, si dhe në databazat e tatimeve dhe doganave.
- Rrisim sigurinë rrugore duke filluar punën për ndryshimet në kodin rrugor dhe për rritjen e investimeve në sistemet e monitorimit të trafikut dhe digjitalizimin e proceseve që kanë të bëjnë me përdoruesit e automjeteve dhe sjelljen e tyre

6. Siguria e pronës

Statusi:Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 37. Siguria e pronës.

- I japim fund procesit 30-vjeçar të ndërtimeve pa leje brenda vitit 2022, ku asnjë banesë shqiptare që mund të legalizohet, nuk do të ketë mbetur pa u legalizuar.
- Digjitalizojmë të gjitha shërbimet për pronësinë dhe modernizojmë sistemet për shërbim në kohë reale për qytetaret.
- Përfundojmë procesin e regjistrimit fillestar të pasurive në të gjithë zonat kadastrale të bregdetit.
- Digjitalizojmë kadastrën duke e kthyer shërbimin kadastror një shërbim të aksesueshëm me një klik nga qytetarët përmes e-albania

7. Krijimin e një shteti dixhital në të gjitha shërbimet

Statusi: Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 27. Shoqëria digjitale.

- Realizojmë platformën e-Rezidenca për mundësimin e investimeve të huaja pa nevojën e prezencës fizike të investitorëve, duke përdorur identitetin digjital dhe shërbimet elektronike në e-Albania.
- Zgjerojmë rrjetin qeveritar GovNet për të ulur koston e shërbimit të internetit për institucionet shtetërore dhe rritjen e sigurisë së të dhënave.
- Bëjmë të mundur njohjen e nënshkrimit dhe vulës elektronike me vendet e rajonit

8. Fillojmë punimet për ndërtimin e Muzeut Hebraik Shqiptar si pjesë integrale e projektit të rivitalizimit të Qendrës Historike të Vlorës

Statusi: Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 26. Kultura

9. Ndërtojmë Parkun e Artit, një hapësirë social-kulturore në zonën e ish-Kinostudios “Shqipëria e Re”, duke përfshirë edhe zonën përreth saj, ku parashikohet dhe ndërtimi i Muzeut të Filmit, i cili synon transformimin e AQSHF në një njësi bashkëkohore të ruajtjes dhe promovimit të filmit shqiptar, sipas standardeve të kohës

Statusi: Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 26. Kultura

10. Vendosim në funksionim Skemën Kombëtare “Bonusi i Rijetëzimit”, një financim për restaurimin dhe kthimin e objekteve brenda qendrave historike, në modele të qëndrueshme biznesi, që gjenerojnë të ardhura dhe punësim për komunitetin

Statusi: Në progres

Programi Qeverisës 2021 -2025. Faqe 26. Kultura

POLITIFAKT.

JU DUKENI SI NE,

POR NUK NGJANI ME NE!



POR NUK NGJANI ME NE!

JU DUKENI SI NE,

POLITIFAKT.